



REPUBLIKA E KOSOVË AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-0/DPK</u> Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u> Nr. pages	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-1188/15</u> Prot. No. Data Datum <u>20-04-2015</u> Date PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	20.04.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Adem DURIQI Drejtor i Drejtoratit të Prokurimit në Komunën e Lipjanit
CC:	z. Imri AHMETI Kryetar i Komunës së Lipjanit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Renovimi i kulmit dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve të shkollës Rexhep Akllapi në Akllap "

Inderuari z. Duriqi ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Renovimi i kulmit dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve të shkollës Rexhep Akllapi në Akllap " me numër të prokurimit: 93060 15 013 521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Renovimi i kulmit dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve të shkollës Rexhep Akllapi në Akllap " me numër të prokurimit: 93060 15 013 521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik

Arsyetim

Komuna e Lipjanit si Autoritet kontraktues, përmes Drejtoratit për Prokurim ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " Renovimi i kulmit dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve të shkollës Rexhep Akllapi në Akllap" me numër prokurimi: 93060 15 013 521, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.25.02.2015 në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 25.02.2015 tek rubrika III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 1. Ka kërkuar Qarkullimi i realizuar nga projektet e njëjta në vlerë prej 40.000.00€ për të gjitha lotët edhe pse tenderi nuk është i ndarë në lote, dhe tek pika 2.Referencat për punë në ndërtimtari kërkesa këto të cilat konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Sipas LPP-së, një Autoritet kontraktues mundet të kërkojë dëshmi me të cilat do ta vërtetonte Kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, atëherë kërkesat për qarkullim duhet t'i referohen maksimum tri viteve të fundit financiare të përfunduara nga data e publikimit të njoftimit të kontratës. Vitet e tilla financiare do të tregohen shprehimisht në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Në njoftimin për kontratë tek rubrika kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare janë kërkuar edhe Kontrata për punë të kryera në këtë lëmi, kërkesë kjo në kundërshtim me ligjin, pasi që Legjislacioni në fuqi e parasheh se Autoriteti kontraktues mund të caktojë një kriter të tillë të përzgjedhjes për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale të Operatorit ekonomik, por nuk lejohet në asnjë mënyrë që një kërkesë të tillë ta kërkojë për të dëshmuar aftësinë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare.

Sipas detyrës zyrtare Agjencia kundër Korrupsionit, njofton Autoritetin Kontraktues-Komunën e Lipjanit se do të jetë pjesë e vëzhgimit në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave për aktivitetin e Prokurimit: " Renovimi i kulmit dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve të shkollës Rexhep Akllapi në Akllap ".

Gjatë monitorimit të komisionit vlerësues AKK konstaton se për këtë aktivitet të prokurimit Dosjen e Tenderit e kanë dorëzuar gjithsej 24 Operatorë Ekonomik ku **14 nga këta janë të përgjegjshëm** duke i plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, të cilët operator kanë ofruar qarkullim financiar si dhe referenca për punë në ndërtimtari duke iu referuar tri viteve të fundit (2012, 2013 dhe 2014), ndërsa 10 prej tyre janë të papërgjegjshëm pasi që nuk i kanë plotësuar kriteret e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Agjencia rekomandon autoritetin kontaktues që për aktivitet e prokurimit ne te ardhmen kërkesat financiare, teknike dhe profesionale ti përpilojë në 137 pajtueshmëri me nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare, nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, dhe nenin 5 Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Me respekt !